



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 53, datë 25.06.2020

**PËR
MIRATIMIN E VËRTETIMIT TË LËSHUAR NGA KRYETARI I FSHATIT
DHE ADMINISTRATORI I NJËSISË ADMINISTRATIVE SI PJESË E
DOKUMENTACIONIT TË DOSJES SË APLIKUESIT PËR TË
PËRFITUAR NGA PROGRAMET E RINDËRTIMIT**

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjin nr.44/2015, “Kodi i Proçedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, Ligjit nr.97/2019 “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e Ligjit nr.9, datë 16.12.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, Vendimin nr. 904, datë 24.12.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe proçedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të proçesit të rindërtimit”, Vendimin nr.5, datë 06.01.2020 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave dhe proçedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projekti model” i ndryshuar, dhe sipas relacionit të hartuar nga Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike, në Bashkinë Durrës me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetares së Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :**

1. Miratimin e vërtetimit të lëshuar nga kryetari i fshatit dhe administratori i njësisë administrative si pjesë e dokumentacionit të dosjes së aplikuesit për të përfituar nga programet e rindërtimit, bashkëngjitur.

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike, Komisioni i Posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit dhe Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).

KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 25.06.2020



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DURRËS

NJËSIA ADMINISTRATIVE _____

Nr _____ Prot.

Durrës, më ___ / ___ /2020

VËRTETIM PËR FAKTE DHE TË DHËNA

Në mbështetje të nenit 71/4 të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", vërtetojmë se familja e Z. _____ me përbërje familjare me numër _____,

Nr	Emër Atësi Mbiemër	Datëlindja	Gjendja familjare	Dokument i identifikimit
1				
2				
3				
4				
5				

banor i njësisë administrative Manëz me numër çertifikate familjare në fshatin _____, dhe me vendbanim deri me 26.11.2019 ditë kur ka ndodhur fatkeqesia natyrore,

Vërtetoj se kjo familje ka jetuar në objektin me të dhënat e mëposhtme:

Objekti : Shtëpi banimi me numër kate _____

Nr. objektit _____

Rruga _____

Zona Kadastrale _____

Nr. Giz _____

Viti i ndërtimit të banesës _____

Kjo vërtetohet edhe nga:

Numri i kontratës së energjisë elektrike _____ dhe detyrimeve të pagesave nëpërmejt faturave përkatëse

Numri i kontratës së ujësjellës kanalizimeve _____ dhe detyrimeve të pagesave nëpërmejt faturave përkatëse


Ky vërtetim lëshohet për vazhdimin e procedurave të mëtejshme për proceset që do të ndiqen nga instancat përkatëse për banesën e dëmtuar nga tërmeti i datës 26.11.2019.

Kryetari i Fshatit

Kryetari i Nj. Administrative

Emër Mbiemër

Emër Mbiemër



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 574 / Prot.
3

Durrës, më 29.06.2020

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK ✓
DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr. 53, datë 25.06.2020 “Për miratimin e vërtetimit të lëshuar nga kryetari i fshatit dhe administratori i njësisë administrative si pjesë e dokumentacionit të dosjes së aplikuesit për të përfutur nga programet e rindërtimit”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që më jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

